

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 77/16 Gusht 2010), si dhe nenin 103, paragrafi 1, dhe nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 11/11 Maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 27 dhjetor 2018, miratoi këtë:

RREGULLORE

PËR AUDITIMIN E JASHTËM TË INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOBANKARE

Neni 1

Qëllimi dhe përkufizimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kornizën rregullative që ka të bëjë me auditorët e jashtëm të institucioneve financiare jobankare (në vijim: IFJB) dhe të përcaktojë kualitetin e shërbimeve të ofruara nga auditorët e jashtëm, në raport me rreziqet specifike të IFJB-ve dhe të sektorit financiar në përgjithësi. Kjo rregullore përcakton kërkesat për miratimin e auditorëve të jashtëm, kryerjen e auditimit të jashtëm të IFJB-ve dhe marrëdhëniet ndërmjet auditorëve të jashtëm, IFJB-ve dhe BQK-së.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha IFJB-të e regjistruara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës, me përjashtim të IFJB-ve të regjistruara me aktivitet të vetëm këmbimin e valutave për të cilat dispozitat e kësaj rregullore aplikohen vetëm me kërkesë të veçantë të BQK-së për auditimin e pasqyrave financiare apo nëse auditimi i pasqyrave financiare kërkohen me ligjin në fuqi për raportim financiar.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuar në nenin 3 të Ligjit Nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (në vijim: Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB) dhe/ose siç përcaktohet me poshtë për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - 1.1. **Firmë auditimi** nënkupton një person juridik ose çfarëdo entiteti tjetër, pa marrë parasysh formën ligjore, që është e licencuar në përputhshmëri me Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim për të kryer auditim ligjor.

- 1.2. **Pasqyra financiare** nënkupton pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet plotësuese dhe materialet sqaruese të pasqyrave financiare.

Neni 3

Kushtet e përgjithshme

1. Auditori i jashtëm i një IFJB-je të regjistruar nga BQK-ja për të operuar në Kosovë duhet të jetë i licencuar nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (KKRF) dhe i miratuar nga BQK-ja.
2. Bazuar në aplikacionin e shkruar, BQK-ja do të miratojë auditor të jashtëm të një IFJB-je vetëm nëse plotësohen kushtet në vijim:
 - 2.1. Një auditor të jashtëm të licencuar në Kosovë në pajtim me Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.
 - 2.2. Një auditor të jashtëm i cili ka së paku 3 (tre) vjet eksperiencë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të IFJB-ve ose institucioneve tjera financiare, apo stafi pjesëmarrës i të cilit kryen auditimin ka një eksperiencë të tillë.

Neni 4

Kushtet specifike dhe kërkesat

1. Miratimi që i jepet auditorit të jashtëm është i kufizuar për një IFJB specifik dhe është i vlefshëm për një vit financiar.
2. Aplikacionet për miratim duhet të dorëzohen në BQK para datës 30 qershor të secilit vit.
3. IFJB së bashku me aplikacionin për miratim, duhet t'i sigurojë BQK-së:
 - 3.1. Propozimin e Komitetit të Auditimit dhe Bordit të Drejtorëve, për emërimin e auditorit të jashtëm;
 - 3.2. Programin e auditimit të IFJB-së;
 - 3.3. Përshkrimin e shfrytëzimit të burimeve gjatë shërbimit të auditimit;
 - 3.4. Letrën e angazhimit të auditorit të jashtëm ose kontratën e shërbimit të ofruar;
 - 3.5. Dokumentin që vërteton përvojën e mjaftueshme të auditorit të jashtëm apo stafit të tij i cili kryen auditimin në fushën e auditimit të IFJB-ve dhe/ose institucioneve tjera financiare;
 - 3.6. Vërtetimin e lëshuar nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) në lidhje me rezultatet e kontrollit më të fundit të cilësisë për auditorin e jashtëm (ky vërtetim nuk do të kërkohej nga BQK-ja derisa KKRF të mos fillojë të lëshojë një vërtetim të tillë); dhe
 - 3.7. Deklaratën me shkrim të auditorit të jashtëm mbi përmbushjen e kritereve të përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje.
4. Programi i auditimit dhe shfrytëzimi i burimeve gjatë shërbimit të auditimit, duhet të jetë i përshtatshëm në raport me karakterin dhe madhësinë e IFJB-së.

5. Punësimi i vazhdueshëm i auditorit të jashtëm të njëjtë është i kufizuar në tri vite apo tri auditime të njëpasnjëshme.

Neni 5

Reputacioni i mirë

BQK-ja do të aprovojë si auditor të jashtëm të një IFJB-je, auditorët e jashtëm që kanë reputacion të mirë dhe të cilët nuk janë të angazhuar në asnjë aktivitet, i cili është në mospërputhshmëri me funksionet e auditimit të jashtëm.

Neni 6

Ribërja e auditimit

BQK-ja ka të drejtë të kërkojë ribërjen e auditimit nga një tjetër auditor i jashtëm, me shpenzimet e IFJB-së, në rastet kur auditori i jashtëm ekzistues i IFJB-së ka kryer një auditim ose ka paraqitur një raport, i cili nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit për Bankat, IMF dhe IFJB, rregulloret e BQK-së, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (në vijim: SNA) dhe nuk shpreh gjendjen financiare të vërtetë dhe të saktë të IFJB-së.

Neni 7

Etika profesionale

Auditorët e jashtëm duhet t'i nënshtrohen parimeve të etikës profesionale të përcaktuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve: "Kodi i etikës për Kontabilistët Profesional".

Neni 8

Pavarësia dhe objektiviteti

1. Gjatë kryerjes së auditimit, auditorët e jashtëm duhet të jenë të pavarur nga entiteti që auditohet dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshihen në vendimet e menaxhmentit të IFJB-së që auditohet. Auditorët e jashtëm nuk duhet të kryejnë auditimin, nëse ekziston ndonjë marrëdhënie direkte apo indirekte financiare, pune, punësimi apo çfarëdo marrëdhënie tjetër, përfshirë edhe provizionin për shërbimet jo-audituese shtesë, ndërmjet auditorëve të jashtëm dhe IFJB-së që auditohet, nga e cila marrëdhënie një palë e tretë objektive, e arsyeshme dhe e informuar do të mund të konkludonte se pavarësia e auditorëve të jashtëm është kompromentuar.
2. Auditorët e jashtëm të miratuar, gjithashtu, duhet të jenë në pajtim me dispozitat e Rekomandimit të Komisionit Evropian të datës 16 maj 2002 mbi Pavarësinë Statutore të Auditorëve në BE: Struktura e Parimeve Fundamentale. Për më tepër, BQK-ja do të sigurojë pajtueshmëri me Kapitullin IV të Direktivës së BE-së 2006/43 mbi auditimet statusore të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara.
3. Auditorët e jashtëm duhet të dokumentojnë në letrat e punës së auditimit, të gjitha ndërhyrjet në pavarësinë e tyre si dhe masat e sigurisë që i kanë ndërmarrë për zbutjen e ndërhyrjeve të tilla.

Neni 9

Pavarësia dhe objektiviteti i auditorëve të cilët kryejnë një auditim në emër të firmave audituese

Pronarët apo aksionarët e një firme audituese të miratuar, gjithashtu edhe anëtarët e organeve administrative, menaxhuese dhe mbikëqyrëse të asaj firme, apo të një filiali të saj, nuk duhet të ndërhyjnë në ekzekutimin e ndonjë auditimi në çfarëdo mënyre e cila do të rrezikonte pavarësinë dhe objektivitetin e auditorit i cili kryen auditimin në emër të firmës audituese.

Neni 10

Tarifat e auditimit

Tarifat e shërbimeve të auditimit:

1. Kërkohej të jenë adekuate që të mundësojnë kualitetin e duhur të auditimit;
2. Nuk duhet të jenë të influencuara apo të përcaktuara nga provizioni i shërbimeve plotësuese të IFJB-së që auditohet; dhe
3. Nuk mund të bazohen në asnjë formë të kushtëzimit.

Neni 11

Kërkesat ndaj auditorëve të jashtëm në kryerjen e auditimit të llogarive vjetore

Auditorët e jashtëm duhet të kryejnë auditimet në IFJB, në pajtim me SNA.

Neni 12

Përmbajtja e auditimit

1. Auditorët e jashtëm duhet të vlerësojnë nëse llogaritë vjetore të IFJB-ve janë përgatitur dhe finalizuar në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiar (në vijim: SNRF), me Ligjin për Bankat, IMF dhe IFJB, rregulloret e BQK-së si dhe të vlerësojnë nëse menaxhmenti i IFJB-ve e ka plotësuar apo jo obligimin e tij për të siguruar shënime të qarta dhe të duhura si dhe dokumentimin e informatave kontabël në pajtim me Ligjin për Bankat, IMF dhe IFJB dhe rregulloret e BQK-së.
2. Auditorët e jashtëm duhet të vlerësojnë nëse informatat në raportet vjetore lidhur me llogaritë vjetore, supozimet lidhur me vazhdimësinë e operacioneve dhe propozimet në lidhje me shfrytëzimin e tepricave apo mbulimin e humbjeve janë në pajtim me Ligjin për Bankat, IMF dhe IFJB, rregulloret e BQK-së si dhe nëse informata është në pajtim me llogaritë vjetore.
3. Auditorët e jashtëm duhet të vlerësojnë mjaftueshmërinë e sistemeve të menaxhimit të rreziqeve të IFJB-ve duke u bazuar në vlerësimin e:
 - 3.1 Përputhshmërisë me kërkesat për strukturat organizative në lidhje me menaxhimin e çdo rreziku specifik;
 - 3.2 Politikave dhe procedurave për menaxhimin e çdo rreziku specifik si dhe zbatimin të tyre;
 - 3.3 Mjaftueshmërisë së identifikimit, matjes dhe monitorimit të çdo rreziku specifik;

3.4 Mjaftueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të auditimit të brendshëm në lidhje me menaxhimin e çdo rreziku specifik.

4. Rreziqet specifike përfshijnë rrezikun kreditor, rrezikun e tregut, rrezikun operacional, rrezikun e likuiditetit dhe rreziqet tjera ndaj të cilave IFJB-të ekspozohen.
5. Auditorët e jashtëm duhet të kryejnë një vlerësim për IFJB-të lidhur me mënyrën e menaxhimit të mjeteve dhe vendosjen e kontrolleve të brendshme të duhura.
6. Auditimi i IFJB-ve duhet të mbulojë fusha të tilla si portofolin kreditor, rezervat për humbjet nga kreditë, mjetet joperformuese, vlerësimin e mjeteve dhe mjaftueshmërinë e kontrolleve të brendshme mbi raportimin financiar.
7. Auditorët e jashtëm duhet që nëpërmes auditimeve të kontribuojnë në parandalimin dhe shpalosjen e parregullsive dhe gabimeve.

Neni 13

Detyrat e auditorëve të jashtëm

1. Auditorët e jashtëm duhet të kryejnë auditimet sipas gjykimit të tyre më të mirë, përfshirë vlerësimin e rrezikut që paraqet përfshirja e informatave të gabuara në llogaritë vjetore për shkak të parregullsive dhe gabimeve.
2. Auditorët e jashtëm duhet të sigurojnë se kanë bazë të mjaftueshme për të vlerësuar nëse është bërë ndonjë shkelje e Ligjit për Banka, IMF dhe IFJB si dhe rregulloret e BQK-së, të cilat janë materiale sa i përket llogarive vjetore.
3. Auditorët e jashtëm duhet të kontrollojnë rregullsinë, saktësinë dhe plotësinë e raportimeve të IFJB-së të paraqitura në BQK, në përputhje me kërkesat rregullative në fuqi të miratuara nga BQK-ja. Bazuar në kontrollin e ushtruar auditorët e jashtëm duhet të vlerësojnë nëse raportimet janë kryer ose janë në përputhje me Ligjin për Banka, IMF dhe IFJB dhe rregulloret e BQK-së dhe nëse ato pasqyrojnë në mënyrë realiste dhe objektive gjendjen financiare të IFJB-së.
4. Auditorët e jashtëm duhet t'i paraqesin me shkrim Bordit të Drejtorëve të IFJB-së rrethanat e poshtëshënuara:
 - 4.1 Mangësitë në lidhje me detyrimin për të siguruar regjistrimin e duhur, shpalosjen e qartë dhe dokumentimin e informatave kontabël;
 - 4.2 Gabimet dhe mangësitë në organizimin dhe kontrollin e menaxhimit të mjeteve;
 - 4.3 Parregullsitë dhe gabimet që mund të shkaktojnë informim të gabuar në llogaritë vjetore.

Neni 14

Dokumentimi i kryerjes së detyrës

Ashtu siç kërkohet me SNA 230 "Dokumentimi i Auditimit", auditorët e jashtëm duhet të dokumentojnë se si është kryer një auditim si dhe rezultatet e një auditimi. Çështjet të cilat tregojnë se parregullsitë ose gabimet mund të jenë të pranishme duhet të dokumentohen veçmas.

Neni 15

Mirëmbajtja e letrave të punës së auditimit

Letrat e punës së auditimit duhet të përgatiten dhe mirëmbahen në pajtim me SNA përkatës.

Neni 16

Raporti i auditorëve të jashtëm

1. Auditorët e jashtëm duhet të përgatisin një raport vjetor të auditimit me një opinion të auditimit në pajtim me SNRF dhe në rast të paraqitjes së diferencave materiale, gjithashtu edhe një raport të auditimit me një opinion të auditimit në pajtim me rregulloret e BQK-së.
2. Raporti i auditimit duhet të konfirmojë që shërbimet e auditimit janë kryer në pajtim me dispozitat e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, kësaj rregulloreje dhe rregulloreve tjera relevante të BQK-së.
3. Raporti i auditimit duhet të verifikojë dhe shpalosë çështjet në vijim:
 - 3.1 Nëse llogaritë vjetore janë përgatitur dhe finalizuar në pajtim me SNRF, Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dhe rregulloret përkatëse të BQK-së, si dhe nëse ato paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare dhe aktiviteteve të IFJB-së;
 - 3.2 Nëse menaxhmenti i IFJB-së e ka përmbushur obligimin e tij, për të siguruar shënime të qarta dhe të duhura si dhe dokumentimin e informatave kontabël; dhe
 - 3.3 Nëse informatat në raportin vjetor në lidhje me llogaritë vjetore, supozimet lidhur me vazhdimësinë e operacioneve dhe propozimet në lidhje me shfrytëzimin e tepricave apo mbulimin e humbjeve janë në pajtim me Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dhe rregulloret përkatëse të BQK-së.
4. Nëse llogaritë nuk japin informata lidhur me rezultatin dhe gjendjen e IFJB-së, e që duhet të sigurohen, auditorët e jashtëm duhet ta theksojnë këtë, ose të përcaktojnë rezervat e auditorëve dhe mundësisht të sigurojnë edhe informata të nevojshme plotësuese në raportin e auditimit.
5. Nëse auditorët e jashtëm arrijnë në përfundim se llogaritë nuk duhet të finalizohen në formën e tyre aktuale, kjo duhet të theksohet në mënyrë të qartë.
6. Auditorët e jashtëm duhet të vlerësojnë zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditorët e jashtëm për vitin e kaluar financiar.

Neni 17

Letra e menaxhmentit

1. Auditorët, duhet që në pajtim me legjislacionin primar dhe atë sekondar të BQK-së, të përgatisin letrën e menaxhmentit për institucionin financiar, për konkludimet e procesit të auditimit. Letra e menaxhmentit duhet të përfshijë të gjitha konkluzionet në të cilat ka arritur auditori në lidhje me aktivitetin apo gjendjen financiare të institucionit financiar, si dhe informatat në lidhje me kujdesin e tyre të performuar në mision të auditimit.
2. Në letrën e menaxhmentit, auditorët, duhet të japin një deklaratë specifike, në lidhje me sistemin e kontrollave të brendshme me qëllim të japin siguri specifike mbi, dhe për qëllim

të shpalesjes së çështjeve materiale në strukturën e kontrollit të brendshëm. Deklarata specifike, duhet, gjithashtu, të përfshijë funksionin e auditimit të brendshëm.

Neni 18

Detyrimi për ruajtjen e fshehtësisë

1. Auditorët e jashtëm dhe bashkëpunëtorët e auditorëve të jashtëm, kanë për detyrë të ruajnë fshehtësitë sa i përket çfarëdo njohurie të përfituar gjatë kohës së aktiviteteve të tyre, përveç nëse me ligj përcaktohet ndryshe, apo në rastet kur informata ka të bëjë me personin detyra e të cilit nuk kërkon fshehtësinë profesionale. Auditorët e jashtëm dhe bashkëpunëtorët e auditorëve të jashtëm nuk mund t'i shfrytëzojnë ato informata për aktivitetet e veta, për shërbim apo punësim të të tjerëve.
2. Auditorët e jashtëm, pa marrë parasysh kufizimet e paraqitura në paragrafin 1 të këtij neni apo të marrëveshjes për fshehtësi, mund të japin shpjegime dhe paraqesin dokumentacionin rreth auditimit të kryer, në rastet kur kërkohet me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
3. Detyrimi i mbajtjes së fshehtësisë vazhdon të zbatohet edhe pasi të ketë përfunduar detyra e tillë.

Neni 19

Obligimi për të informuar

1. Auditori i jashtëm brenda kornizave të detyrës së tij duhet të ofrojë informata në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me IFJB, të cilat auditori i jashtëm i ka mësuar gjatë kohës së auditimit, kur kjo kërkohet nga mbledhja e përgjithshme e aksionarëve, bordi i drejtorëve, menaxhmenti i lartë, komiteti i auditimit apo nga një person i autorizuar nga BQK-ja.
2. Auditori i jashtëm, duhet menjëherë të njoftojë komitetin e auditimit apo bordin e drejtorëve të IFJB-së dhe BQK-në, në rastet kur gjatë kryerjes së auditimit të IFJB-së vëren:
 - 2.1. konflikt serioz brenda organeve vendimmarrëse apo largimin e papritur të menaxherit që ka pasur funksion kyç;
 - 2.2. informatën e cila tregon se mund të ketë shkelje materiale të ligjeve në fuqi dhe rregulloreve, udhëzimeve dhe urdhrave të BQK-së si dhe statutit dhe të akteve nënligjore të IFJB-së; ose
 - 2.3. synimin e auditorit të brendshëm për të dhënë dorëheqje apo largimin e tij; dhe ndryshimet negative apo materiale që paraqesin rrezik për punën e IFJB-së dhe mundësinë që rreziku të vazhdojë.
3. Auditori i jashtëm, duhet që në bazë të kërkesës së BQK-së, t'i ofrojë BQK-së çfarëdo informate gjatë tërë misionit të auditimit, në lidhje me performancën e tij në shërbimet e auditimit në një IFJB.
4. BQK-ja mban kontakte të rregullta dhe mund të iniciojë takime me auditorin e jashtëm të IFJB-së në çdo kohë, kur kontaktet e tilla konsiderohen të nevojshme.

Neni 20

Kontrolli i cilësisë dhe rishikimi tij

1. Auditorët e jashtëm të miratuar nga BQK-ja duhet të aplikojnë politikat dhe procedurat adekuate të kontrollit të cilësisë të cilat i adresojnë të gjitha aspektet e rëndësishme të auditimit.
2. Auditorët e jashtëm të miratuar nga BQK-ja, do të jenë subjekt i një rishikimi të cilësisë së dhënies së sigurisë, nga ana e BQK-së.
3. Rishikimi i cilësisë së një auditori të jashtëm të miratuar duhet të përfshijë një detyrë specifike të auditimit dhe duhet të kryhet nga ana e BQK-së apo nga ana e një rishikuesi të caktuar nga BQK-ja.
4. Gjatë rishikimit të cilësisë, BQK-ja apo rishikuesi duhet të përcaktojë se deri në çfarë shtrirje, auditori i jashtëm i ka aplikuar rregullat dhe procedurat adekuate të kontrollit të cilësisë në të gjitha aspektet e rëndësishme të auditimit. Gjatë rishikimit, BQK-ja apo rishikuesi duhet të ketë qasje në të gjitha dokumentet e punës së auditorit të jashtëm, deri në atë masë që është e nevojshme për të kryer një kontroll adekuat të cilësisë.
5. Duke pasur parasysh obligimet për ruajtjen e fshehtësisë, neni 18 i kësaj rregulloreje aplikohet njëjtë si për BQK-në ashtu edhe për rishikuesin.
6. Rezultatet e përmbledhura të rishikimit të cilësisë së dhënies së sigurisë do të publikohen nga BQK-ja, duke përfshirë rekomandimet, zbatimin e rekomandimeve dhe nëse ndodhë ndonjë rast edhe sanksionet.

Neni 21

Shkarkimi dhe dorëheqja

1. Auditorët e jashtëm të IFJB-ve mund të shkarkohen kur ekzistojnë baza të mjaftueshme për këtë. Dallimet e opinionëve të trajtimeve në kontabilitet ose në procedura të auditimit, nuk mund të konsiderohen si bazë e mjaftueshme për shkarkim.
2. Si IFJB-të e audituara ashtu edhe auditorët e jashtëm, duhet të informojnë BQK-në në rast të shkarkimit apo të dorëheqjes dhe duhet të japin shpjegime të mjaftueshme për arsyet e një vendimi të tillë.

Neni 22

Tërheqja e miratimit

Miratimi i auditorit të jashtëm do të tërhiqet nëse reputacioni i mirë i asaj firme audituese është kompromentuar seriozisht apo nëse njëra nga kërkesat e kësaj rregulloreje nuk përmbushet më.

Neni 23

Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

1. Nëse auditorët e jashtëm të IFJB-ve shkelin detyrat e auditorit, të përcaktuara me kornizën përkatëse ligjore në fuqi, dispozitat e kësaj rregulloreje si dhe rregulloreve të tjera përkatëse të

BQK-së, BQK-ja mund t'i shqiptojë auditorit të jashtëm vërejtje me shkrim, një kopje e së cilës do t'i dërgohet IFJB-së së audituar.

2. Nëse shkeljet e përshkruara në paragrafin 1. të këtij neni përsëriten, BQK-ja ka të drejtë të:
 - 2.1 refuzojë miratimin e auditorit të jashtëm për t'u angazhuar në kryerjen e auditimit të institucioneve financiare të licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës; ndalesa për miratimin e auditorit të jashtëm mund të bëhet deri në tri (3) vite;
 - 2.2 kërkojë largimin apo zëvendësimin e një auditori;
 - 2.3 drejtpërdrejt të emërojë, largojë apo zëvendësojë një auditor, apo
 - 2.4 kërkojë ribërjen e auditimit sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje.

Neni 24 **Shfuqizimi**

Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, Rregulla e amendamentuar mbi auditimin e jashtëm dhe auditorët e jashtëm të institucioneve financiare, e miratuar me 18 shkurt 2008, shfuqizohet sa i përket auditimit të jashtëm të IFJB-ve.

Neni 25 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit.

Flamur Mrasori

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore